



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 92
Prishtinë, më 13 dhjetor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 13 DHJETOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Shaip Muja, Hykmete Bajrami, Alma Lama, Time Kadrijaj, Aurora Bakalli, Bekim Haxhiu, Haki Demolli, Albulena Haxhiu dhe Berat Buzhala, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për zv.kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se me kë është konsultuar gjatë hartimit të Projektligjit për përgjimet, i cili u miratua në mbledhjen e Qeverisë, më 3 dhjetor 2012.

Zv.kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për zv.kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se më 29 nëntor 2012, Qeveria e Kosovës deklaroi se: *“publikimi i përgjimeve të tilla të fabrikuara me qëllim të shantazhimit të personaliteteve institucionale dhe jetës së tyre private është vepër e kundërligjshme dhe e dënueshme”*. Po atë ditë, EULEX-i e konfirmoi se janë të vërteta. Cila është përgjigja e Qeverisë? Janë të vërteta ato çfarë thuhet në incizimet që i dëgjoji opinioni publik.

Zv.kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me borxhin e qytetarëve ndaj KEK-ut, për të cilin është deklaruar publikisht se do ta mbledhë konsorciumi “Limak-Çalik”. Në ç’mënyrë dhe sa është përqindja. Cila është baza ligjore që ju lejon t’ia kaloni përqindjen nga mbledhja e këtij borxhi konsorciumit?

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me zëvendësimin e kodeve telefonike aktuale në Kosovë, në bazë të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 6 shtator 2012.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

Deputetja Albana Gashi parashtroi pyetje për ministren Vlora Çitaku në lidhje me atë se cilat janë shkeljet që ka vërejtur Auditori, cilat masa administrative i keni ndërmarrë dhe me urdhër të kujt janë shkelur procedurat e rekrutimit në Ministrinë e Integriteteve Evropiane?

Ministrja Vlora Çitaku nuk ishte e pranishme në sallë.

Deputeti Fikrim Damka kishte adresuar pyetje për ministrin Radojica Tomiq.

Kryetari konstatoi se deputeti Fikrim Damka ka marrë përgjigje në formë të shkruar nga ministri Radojica Tomiq.

Deputeti Liburn Aliu parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me detajet e vrasjeve të katër të rinjve shqiptarë, shtetas të Republikës së Maqedonisë dhe të Republikës së Kosovës, në fshatin kufitar Radushë të Maqedonisë, që kanë mbetur enigmë për qytetarët shqiptarë të të dyjave republikave, si dhe arsyetimin e organeve të Maqedonisë në lidhje me këto vrasje.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Liburn Aliu.

Deputeti Liburn Aliu parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me atë se a janë involvuar në çfarëdo mënyre, qoftë në këmbim informatash, qoftë drejtpërdrejt, organet

institucionale të Republikës së Kosovës në vrasjen e katër të rinjve shqiptarë në fshatin kufitar Radushë.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Liburn Aliu.

Deputeti Afrim Kasolli parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me listën e personave të kërkuar në Republikën e Maqedonisë, e të cilët dyshohej se fshihen në Kosovë dhe për të cilët ju do të duhej ta ndihmonit Republikën e Maqedonisë.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Afrim Kasolli.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013,
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagave dhe kompensimeve të anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të pavarura,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pyjet,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parkun kombëtar “Sharri”,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësi,
17. Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit të procedurës penale,
18. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Kuvendi e miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 6 dhjetor 2012.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Për këtë pikë të rendit të ditës nga Qeveria e Kosovës nuk e mori fjalën askush, por as nga grupet parlamentare dhe as nga deputetët nuk pati të paraqitur për diskutim.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 94 deputetë.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	89,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL e arsyetoi kryetarja e këtij Komisioni, deputetja Safete Hadërgjonaj.

Deputeti Lutfi Haziri foli në emër të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian, Diskutimet e deputetëve Hadërgjonaj dhe Haziri janë dhënë të plota në transkript.

Deputetja Alma Lama diskutoi në lidhje me amendamentin 43, të propozuar nga ajo, për të cilin tha se me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL është përfshirë në amendamentin 29, pika 4. Diskutimi i plotë i deputetes Alma Lama është dhënë në transkript.

Në lidhje me këtë çështje diskutuan edhe deputetët Naser Osmani dhe Safete Hadërgjonaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari konstatoi se amendamenti 43, i propozuar nga deputetja Alma Lama, ka mbetur pa objekt, sepse i njëjti amendament është përfshirë në pikën 4 të amendamentit 29, i përkrahur nga Komisioni FunkSIONAL.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 46 dhe amendamentin nr. 49.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet: 44, 45, 47 dhe amendamentin nr. 48.

Në lidhje me amendamentin 44, 45 dhe 47 diskutuan deputetët Nijazi Idrizi dhe Safete Hadërgjonaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në lidhje me amendamentin 48, diskutuan deputetët: Naser Osmani, Jakup Krasniqi, Nait Hasani, ministri Bedri Hamza, Armend Zemaj, Daut Haradinaj dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari hodhi në votim miratimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 26,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagave dhe kompensimeve të anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të pavarura

Kryetari i njoftoi deputetët për Propozim-vendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagave dhe kompensimeve të anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të pavarura.

Për këtë pikë të rendit të ditës nga Qeveria e Kosovës nuk e mori fjalën askush, por as nga grupet parlamentare dhe as nga deputetët nuk pati të paraqitur për diskutim.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagave dhe kompensimeve të anëtarëve të institucioneve dhe agjencive të pavarura.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 73,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e pagave dhe të kompensimeve për anëtarët e institucioneve dhe të agjencive të pavarura

I. Pagat dhe kompensimet e anëtarëve të institucioneve dhe të agjencive të pavarura janë, si në vijim:

1. Paga e Avokatit të Popullit, në shumë prej 1 443 euro në muaj,
2. Paga e zëvendës/avokatit të Popullit, në shumë prej 1 271 euro në muaj,
3. Paga e kryetarit të Këshillit të Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës, në shumë prej 1 200 euro në muaj,
4. Paga e anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës, në shumë prej 1 050 euro në muaj,
5. Kompensimi për kryetarin e Komisionit të Pavarur për Media, në shumë prej 800 euro në muaj,
6. Kompensimi për anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media, në shumë prej 600 euro në muaj,
7. Kompensimi për kryetarin e Bordit për Ankesa, në shumë prej 700 euro në muaj,
8. Kompensimi për anëtarët e Bordit për Ankesa, në shumë prej 550 euro në muaj,
9. Kompensimi fiks për kryeshefin ekzekutiv/anëtar i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, në shumë prej 490 euro në muaj.

II. Niveli i pagave dhe i kompensimeve për anëtarët e institucioneve dhe të agjencive të pavarura, sipas pikës **I.** të këtij vendimi do të zbatohet nga 1 janari 2013 dhe deri në miratimin e Ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë publikë.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si propozues i Projektligjit, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet.

Deputeti Zenun Pajaziti tha se pas mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për miniera dhe minerale nr. 03/L-163, në vitin 2011, Komisioni që ai udhëheq ka ardhur në përfundim se duhet të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit në pika të caktuara, të cilat janë evidentuar si të pazbatueshme. Më tej, ai theksoi se me këtë projektligj do të mundësohet krijimi i një ambienti më të favorshëm për investime direkte në përputhje të plotë me procedurat e përcaktuara me Ligjin për partneritet publiko-privat.

Në vazhdim, ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për minierat dhe mineralet.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, për këtë Projektligj diskutoi ministri Besim Beqaj.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re dhe Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe Sala Berisha-Shala, Hashim Deshishku, Zenun Pajaziti dhe ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi Xhavit Haliti e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 39,
Kundër -----17,
Abstenime ----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funkcional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pyjet

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, si propozues i projektligjit, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për pyjet.

Ministri Blerand Stavileci tha se ky projektligj, në një mënyrë ose në një tjetër është i lidhur me dy projektligjet që sot janë në lexim të dytë - Projektligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe se këto 3 projektligje do të duhej që të miratohen në pako, ose të mos miratohen fare, për arsyen, siç tha ai, se çështjet që i adresojnë këto projektligje janë sistematike dhe strukturore. Ai tha se çështjeve që lidhen me këto tri projektligje është dashur t’u bëhet një analizë më e mirë. Ai i ftoi deputetët për miratimin e Projektligjit për pyjet.

Diskutimi i plotë i ministrit Blerand Stavileci është dhënë në transkript.

Deputeti Nait Hasani, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, tha se Komisioni Parlamentar që ai drejton ka rekomanduar që ky projektligj të mos miratohet në parim, me arsyetim se teksti i këtij projektligji nuk ka ndryshime qenësore në krahasim me Ligjin në fuqi.

Diskutimi i plotë i deputetit Nait Hasani është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për pyjet.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu,

në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Daut Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Bekim Haxhiu, ministri Dardan Gashi, ministri Blerand Stavileci, Liburn Aliu dhe Nait Hasani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi Xhavit Haliti e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, që ky projektligj të mos miratohet në parim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 46,
Kundër -----17,
Abstenime ----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Kuvendi nuk e miratoi në parim Projektligjin për pyjet.
2. Ngarkohet Qeveria e Republikës së Kosovës për hartimin e Projektligjit të ri për pyjet.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit Funkcional e arsyetoi kryetari i këtij Komisioni, deputeti Nait Hasani, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Daut Haradinaj, Nijazi Idrizi dhe Nait Hasani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 34,
Kundër----- 25,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parkun kombëtar “Sharri”

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL e arsyetoi kryetari i këtij Komisioni, deputeti Nait Hasani, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për parkun kombëtar “Sharri”, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 42,
Kundër ----- 15,
Abstenime ----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për Parkun Kombëtar “Sharri”.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL e arsyetoi kryetari i këtij Komisioni, deputeti Nait Hasani, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Kryetari hodhi në votim miratimin e Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 47,
Kundër ----- 14,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për regjistrimin e bujqësisë.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e bimëve

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e bimëve dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL e arsyetoi kryetari i këtij Komisioni, deputeti Nait Hasani, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për mbrojtjen e bimëve me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	56,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për mbrojtjen e bimëve.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL e arsyetoi kryetari i këtij Komisioni, deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	50,
Kundër -----	4,
Abstenime -----	4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për punimet nga metalet e çmuara.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit Funksional e arsyetoi kryetarja e këtij Komisioni, deputetja Safete Hadërgjonaj, diskutimi i plotë i së cilës është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 14.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	53,
Kundër -----	1,
Abstenime -----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit Funksional e arsyetoi anëtarja e këtij Komisioni, deputetja Xhevahire Izmaku, diskutimi i plotë i së cilës është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Kuvendi nuk e miratoi amendamentin nr. 15.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës.

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësi

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për shëndetësi dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL e arsyetoi kryetari i këtij Komisioni, deputeti Fikrim Damka, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Shaip Muja, Nait Hasani, Liburn Aliu, Bekim Haxhiu, Ismet Beqiri, Flora Brovina, Time Kadrijaj, Armend Zemaj, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa, Bahri Thaqi, ministri Ferid Agani dhe Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Deputeti Liburn Aliu deklaroi se i tërheq amendamentet e propozuara: 3B, 23 dhe 50B, me arsyetimin se përmbajtja e tyre ishte përfshirë në amendamentet e Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1, 2, 3A, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30A, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50A, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59 dhe 60.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për shëndetësi me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 43,
Kundër ----- 18,
Abstenime ----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin për shëndetësi.

17. Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit të procedurës penale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projekt-kodin e procedurës penale dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL e arsyetoi nënkryetari i këtij Komisioni, deputeti Behar Selimi, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet nga numri 1 deri te amendamenti numër 256, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Kuvendi një nga një miratoi amendamentet nga numri 1 deri te amendamenti numër 256, të propozuara në Raportin e Komisioni FunkSIONAL.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Projekt-kodit të procedurës penale me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	59,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projekt-kodin e procedurës penale.

18. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

Deputeti Albin Kurti, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Jashtme, tha se si komision e kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia kemi paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni FunkSIONAL.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti me rekomandimet e paraqitura nga Komisioni FunkSIONAL.

Diskutimi i plotë i deputetit Albin Kurti është dhënë në transkript.

Për këtë raport, në emër të Qeverisë së Kosovës diskutoi edhe ministri Enver Hoxhaj, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Skënder Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, si dhe Emilija Rexhepi, ministri Enver Hoxhaj dhe Albin Kurti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e Raportit me rekomandime të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i deklaroi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale